REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

DEPARTAMENTI I PROGRAMIMIT DHE ADMINISTRIMIT TË BUXHETIT

DREJTORIA E PROGRAMIMIT DHE MONITORIMIT TË BUXHETIT

L ë n d a: *Mbi efektin financiar të propozimit për shtesën e numrit të gjyqtarëve dhe shtesë të stafit administrativ gjyqësor,*

Në vijim të punës për rishikimin e numrit të gjyqtarëve në sistemin gjyqësor, bazuar në materialet e përcjella për shqyrtim, të përgatitura deri në këtë fazë, përkatësisht projekt-relacionin mbi studimin, përmbledhjen ekzekutive, metodologjinë e përdorur, si dhe shtojcat përkatëse në format Excel me të dhënat, llogaritjet dhe formulat mbështetëse, Departamenti i Programimit dhe Administrimit të Buxhetit, ka realizuar një përllogaritje të përafërt të efektit financiar, që vjen nga rritja e numrit të gjyqtarëve, me 102 vende të përhershme e cila duhet të shoqërohet domosdoshmërisht me shtimin e administratës gjyqësore, së paku me 336 punonjës jogjyqtarë, e cila konsiston se ka një efekt financiar për një vit buxhetor, në shpenzime personeli në shumën prej **424,000 mijë lekë** për 102 gjyqtarë dhe në shumën prej **656,000 mijë lekë** për 336 punonjës jogjyqtarë (nga të cilët 102 ndihmës ligjore dhe 234 nëpunës civil gjyqësor).

Ndërsa paketa e përkohshme prej 9 gjyqtarësh në Gjykatën e Lartë, e cila kërkon rreth 56 punonjës shtesë, ka një efekt financiar në shpenzime personeli në shumën prej **48,000 mijë lekë** për 9 gjyqtarë dhe në shumën prej **93,000 mijë lekë** për 56 punonjës jogjyqtarë (nëpunës civil gjyqësor).

Pra, efekt financiar për një vit buxhetor, të propozimit për shtesë të numrit gjyqtarëve dhe shtesë stafit administrativ gjyqësor, në shpenzime personeli përllogaritet përafërsisht, në shumën prej **1,220,000 mijë lekë**

Ju faleminderit për mirëkuptimin,

Departamenti i Programimit dhe Administrimit të Buxhetit